



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:052315

Datë: 27.01.2023

Numri i dokumentit: 03912676

CP.nr.141/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, duke vendosur në lëndën përbarimore të kreditorëve M.B nga fshati, Komuna e Gjakovës, N.B nga fshati ,Komuna e Gjakovës, K.G nga fshati, Komuna e Gjakovës, M.Ll nga fshati, Komuna e Gjakovës, P.Gj nga fshati, Komuna e Gjakovës, të cilët sipas autorizimeve i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër debitorës Komuna e Gjakovës – DKA në Gjakovë, për shkak kompensimin të shpërblimit jubilar, me vlerë të kredisë 3,263.65 euro, jashtë seancës, me 27 janar 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore, e udhëhequr sipas shenjës CP.nr.141/22, e iniciuar të kreditorëve M.B nga fshati, Komuna e Gjakovës, N.B nga fshati ,Komuna e Gjakovës, K.G nga fshati, Komuna e Gjakovës, M.Ll nga fshati, Komuna e Gjakovës, P.Gj nga fshati, Komuna e Gjakovës kundër debitorës Komuna e Gjakovës – DKA në Gjakovë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitorja.

A r s y e t i m

Kreditorëve të përbarimit M.B nga fshati, Komuna e Gjakovës, N.B nga fshati ,Komuna e Gjakovës, K.G nga fshati, Komuna e Gjakovës, M.Ll nga fshati, Komuna e Gjakovës, P.Gj nga fshati, Komuna e Gjakovës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, ka paraqitur propozimin për përbarim në bazë të dokumentit ekzekutiv Aktgjykimit C.nr.296/21 datë 28.10.2021 i marrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, i ekzekutueshëm nga 26.11.2021, kundër debitorës Komuna e Gjakovës – DKA në Gjakovë dhe i kanë propozuar kësaj gjykatë që të lejoj përbarimin për shkak kompensimin e shpërblimit jubilar , me vlerë të kredisë 3,263.65 euro të debitorit ndaj këtu kreditorit.

Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, me aktvendimin CP.nr.141/22, datë 22.03.2022, ka lejuar përmbarimin ndaj debitores Komuna e Gjakovës – DKA në Gjakovë.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP.nr.141/22, datë 22.03.2022, ka marrë formën e prerë me datë 16.11.2021, gjykata ka nxjerrë urdhër për ekzekutim, me të cilin e ka urdhëruar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitores Komuna e Gjakovës – DKA, të bëjë bartjen e mjeteve sikurse në urdhrin për ekzekutim CP.nr.141/22, datë 09.09.2022, avokatit Ilir Rogova.

I autorizuari i kreditorit, me parashtrësën e datës 03.11.2022, ka njoftuar gjykatën se Thesari i Kosovës, ka vepruar sipas urdhrin të Gjykatës duke i ka ekzekutuar mjetet për destinim për kreditorët, duke theksuar se procedura ka përfunduar në tërësi.

Meqenëse kreditori përmes të autorizuarit të tij e ka njoftuar Gjykatën, se Thesari i Kosovës ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm
CP.nr.141/22, me 27 janar 2027

GJ Y Q T A R J A
Mirjeta Shala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të parashtrohet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.